



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1540/8 prot.

Datë 17.07.2023

V E N D I M
Nr. 635/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2023, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër.1540 prot., datë 04.07.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-64132-03-29-2023 me objekt: “Blerje Leter A4”, me fond limit 2,470,833.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK
Autostrata Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore
Tiranë.
“Rruga e Kavajës” Nd.203 H.1, 1023, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** “Marketing & Distribution” SHPK
Autostrada Tirane - Durres, Km.10, Kashar, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “*Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.03.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-64132-03-29-2023, me objekt “Blerje Leter A4”, me fond limit 2,470,833.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore Tiranë.

II.2. Në datën 03.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3229, si dhe nr. protokolli 1540/2023, datë 04.07.2023 i operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK .

Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 05.07.2023 “Formularin për Publikim” Nr.1065/3 prot.

II.3. Në datën 12.07.2023, operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK, me anë të shkresës protokolluar me tonën me nr.1540/7 prot., datë 14.07.2023, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-64132-03-29-2023 me objekt: “Blerje Leter A4”, me fond limit 2,470,833.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore Tiranë, duke u shprehur se:

“Kërkojmë mosshqyrtimin e ankesës me Nr.A/2023/3229, datë 03.07.2023 nga KPP”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-64132-03-29-2023 me objekt: “Blerje Leter A4”, me fond limit 2,470,833.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore Tirane, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të

ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 1540 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-64132-03-29-2023 me objekt: “Blerje Leter A4”, me fond limit 2,470,833.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare së paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

